


PHILIPS

Soundbar 7.1.2

Fidelio B97



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1 E rëndësishme	2
Siguria	2
Kujdesi për produktin	3
Kujdesi për mjedisin	3
Pajtueshmëria	3
Ndihmë dhe mbështetje	3
2 Produkti juaj	4
Çfarë ka në kuti	4
Njësia kryesore	4
Telekomanda	5
Bokset rrethuese të lëvizshme me valë	6
Subwoofer me valë	6
Konektorët	7
3 Lidhja dhe konfigurimi	8
Vendosja	8
Lidhja me televizorin	9
Lidhja e televizorit ose pajisjeve dixhitale nëpërmjet HDMI	9
Lidhja e audio nga televizori ose nga pajisje të tjera	10
Lidhja me energjinë	10
Lidhja me Subwoofer	10
Çiftimi me bokset rrethuese të lëvizshme me valë	11
Karikimi i bokseve rrethuese të lëvizshme me valë	11
Lidhja me Wi-Fi (punimi me valë)	12

4 Përdorimi i produktit	14
Vendosni bateritë para se ta përdorni telekomandën	14
Rregulloni volumnin	14
Zgjidhja e tingullit	14
Dolby Atmos®	15
Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth	16
Aparati MP3	17
Play-Fi në disa dhoma	17
Chromecast(audio) / AirPlay2 / Alexa 3PDA	17
Dëgjimi i Spotify	17
5 Cilësimet	18
Rregullimi i nivelit të boksit	18
Vendos ndriçimin e ekranit	18
Gjendje pritjeje automatike	18
Vendosja e konfigurimeve të fabrikës	18
6 Përditësimi i softuerit	19
Përditësimi i softuerit nëpërmjet Wi-Fi	19
Përditësimi nëpërmjet USB	19
7 Montimi i produktit në mur	20
Montimi i njësisë kryesore në mur	20
8 Të dhënat e produktit	21
9 Zgjidhja e problemeve	22

1 E rëndësishme

Lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Garancia nuk është e vlefshme nëse dëmtimi shkaktohet nga mosndjekja e udhëzimeve.

Siguria

Rrezik goditjesh elektrike ose zjarri!

- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë shkëputur nga energjia.
- Asnjëherë mos e ekspozoni produktin dhe aksesoret ndaj shiut ose ujit. Asnjëherë mos vendosni enë me lëngje, si për shembull vazo, pranë produktit. Nëse mbi produkt ose brenda produktit derdhen lëngje, hiqeni nga priza menjëherë. Kontaktoni shërbimin e kujdesit ndaj klientit për ta kontrolluar produktin para se ta përdorni.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin dhe aksesoret pranë flakëve të ndezura ose burimeve të tjera të nxehtësisë, si për shembull drita direkte e diellit.
- Asnjëherë mos futni objekte në hapësirat e ventilimit ose në hapësirat e tjera në produkt.
- Në rastet kur spina e energjisë ose një bashkues i pajisjeve përdoret si mjet për shkëputjen nga energjia, mjeti i shkëputjes duhet të jetë në pozicion që arrihet me lehtësi.
- Bateritë (paketa e baterive ose bateritë e instaluara) nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepërt, si për shembull ndaj dritës së diellit, zjarrit ose gjërave të ngjashme.
- Shkëputeni produktin nga energjia para se të ndodhin stuhitë me vetëtima.
- Kur e shkëputni kordonin e energjisë, tërhiqni gjithmonë spinën, asnjëherë kabllon.
- Përdoreni produktin në klima tropikale dhe/ose mesatare.

Rrezik qarku të shkurtër ose zjarri!

- Për të parë shenjat identifikuese dhe vlerat e energjisë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se ta lidhni produktin me prizën e energjisë, sigurohuni që tensioni i energjisë të përputhet me vlerën e printuar mbrapa ose poshtë produktit. Asnjëherë mos e lidhni produktin me prizën e energjisë nëse tensioni është i ndryshëm.

Rrezik lëndimi ose dëmtimi të produkt!

- Për montimin në mur, ky produkt duhet të fiksohet në mur sipas udhëzimeve për montimin. Përdorni vetëm klapën e dhënë për montimin në mur (nëse ka). Montimi jo i mirë në mur mund të shkaktojë aksidente ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni kujdesin për klientin në vendin tuaj.
- Asnjëherë mos e vendosni produktin ose ndonjë objekt tjetër mbi kordonët e energjisë ose mbi pajisje të tjera elektrike.
- Nëse produkti transportohet në temperatura nën 5°C, shpaketojeni produktin dhe prisni derisa temperatura të arrijë temperaturën e ambientit para se ta lidhni me prizën e energjisë.
- Disa pjesë të këtij produkti mund të jenë prej xhami. Trajtojeni me kujdes për të shmangur lëndimet dhe dëmtimet.

Rrezik i nxehtësisë së lartë!

- Asnjëherë mos e instaloni produktin në një hapësirë të mbyllur. Lini gjithnjë një hapësirë prej të paktën dhjetë centimetra anembanë produktit për ajrim. Sigurohuni përdet ose objekte të tjera të mos mbulojnë hapësirat e ventilimit në produkt.

Rrezik kontaminimi!

- Mos i bashkoni bateritë (të vjetrat me të rejat, ose bateritë e karbonit me ato alkaline, etj.).
- Rrezik shpërthimi nëse bateritë nuk vendosen si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Hiqini bateritë nëse janë shkarkuar ose nëse telekomanda nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.

Rrezik i gëlltimit të baterive!

- Produkti/telekomanda mund të ketë një bateri AAA, e cila mund të gëlltitet. Mbajeni gjithnjë baterinë larg fëmijëve! Nëse gëlltitet, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin djegie të brendshme brenda dy orësh pas gëlltimit.
- Nëse dyshoni se një bateri mund të jetë gëlltitur ose futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur i ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterive të jetë komplet i mbyllur pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterive nuk mund të sigurohet mirë, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktoni prodhuesin.



Kjo është një pajisje CLASS II me izolim të dyfishtë, dhe nuk ka tokëzim mbrojtës.



Tensioni AC



Përdorni vetëm furnizimet me energji që tregohen në manualin e përdorimit.

Kujdesi për produktin

Përdorni leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet

e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Pajtuueshmëria

Produkti u përmbahet kërkesave të Komunitetit Evropian për interferencat radio. Këtu TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

Ndihmë dhe mbështetje

Për mbështetje intensive online, vizitoni www.philips.com/support to:

- shkarkoni manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shpejtë
- shikoni udhëzuesit me video (të disponueshme vetëm për disa modele)
- gjeni përgjigje për pyetje të bëra shpesh (FAQ)
- na dërgoni pyetje me email
- bisedoni me përfaqësuesit tanë.

Ndiqni udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit.

Ose mund të kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serisë së produktit. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

2 Produkti juaj


Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips (p.sh. njoftim për përditësimin e softuerit të produktit), regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Çfarë ka në kuti

- Kontrolloni dhe shikoni çfarë ka në kuti:
- Soundbar x1
 - Boks rrethues i lëvizshëm me valë x2
 - Subwoofer me valë x1
 - Telekomandë x1
 - Bateri AAA x2
 - Kordoni i energjisë* x2
 - Adaptor i energjisë x1
 - Kiti i montimit në mur (klapa muri x4, vida x10, upa x6)
 - Manuali i përdorimit
 - Karta e garancisë
 - Dokumenti i të dhënave të sigurisë
 - Udhëzuesi për montimin
- * Sasia e kordonit të energjisë dhe lloji i spinës mund të ndryshojë sipas zonave.

Njësia kryesore

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të njësive kryesore.




- ① **+/- (Volumi)**
Rriteni ose uleni volumen.
- ② **▶|| (Luaj/Pauzë)**
Luani, ndaloni ose vazhdoni luajtjen me Bluetooth.
- ③ **↻ (Burimi)**
• Ju lutemi shtypni një burim hyrjeje për këtë produkt.
- ④ **⏻ (Standby-On)**
• Shtypje e shkurtër: Ndezje / Fikje (Gjysmë-standby)
• Shtypje e gjatë(5 sek): Fikje (Standby ekonomike)
- ⑤ **Ekrani**

⑥ Treguesi LED i energjisë dhe i Wi-Fi

Ngjyra e treguesit LED	Ekrani Paneli	Gjendja e energjisë	Rrjeti Wi-Fi	Burimet e disponueshme për t'u përdorur
E bardhë	Fikur	Standby ekonomike	Shkëputur	Të gjitha burimet janë fikur.
Portokalli	Fikur	Gjysmë-standby	Është lidhur	Play-Fi, Chromecast(Audio), AirPlay2, Alexa 3PDA & Spotify Connect (Këto burime punojnë në sfond.)
Portokalli (pulson)	Ndezur	Ndezja	Duke u lidhur	HDMI, HDMI2, E-ARC(ARC), OPTICAL & BT
Portokalli	Ndezur	Ndezja	Është lidhur	Të gjitha burimet janë gati.

Telekomanda

Në këtë pjesë gjendet një përmbledhje për telekomandën.



1 (Standby-On)

- Shtypje e shkurtër: Ndezje / Fikje (Gjysmë-standby)
- Shtypje e gjatë(5 sek): Fikje (Standby ekonomike)

2 (Burimi)

Zgjidhni një burim hyrjeje për këtë produkt.

- **HDMI 1:** Kalojeni burimin te lidhja HDMI IN 1.
- **HDMI 2:** Kalojeni burimin te lidhja HDMI IN 2.
- **E-ARC:** Kalojeni burimin e te lidhja HDMI E-ARC ose ARC.
- **OPTICAL:** Kalojeni burimin e audios te lidhja optike.
- **AUDIO IN:** Kalojeni burimin e audios te lidhja AUDIO IN (xhek 3,5 mm).
- **BT:** Kaloni në modalitetin Bluetooth.

Shënim

Play-Fi multi-room, Chromecast(Audio), AirPlay2, Alexa 3PDA & Spotify Connect punojnë në sfond kur Wi-Fi është i lidhur. Këto zgjidhen dhe kontrollohen nga pajisja/aplikacioni transmetues përkatës.

3 Butonat e navigimit

- Lart: Rriteni volumn ose zgjidhni artikullin e mëparshëm në menunë kryesore.
- Poshtë: Uleni volumn ose zgjidhni artikullin tjetër në menu.
- Majtas: Kaloni te kënga e mëparshme në modalitetin e luajtjes ose zgjidhni nivelin poshtë në modalitetin e menusë.
- Djathtas: Kaloni te kënga tjetër në modalitetin e luajtjes ose zgjidhni nivelin lart në modalitetin e menusë.
- Qendër: Luani, ndaloni ose vazhdoni në modalitetin e luajtjes. Konfirmoni një zgjedhje.

4 (Menu)

Hyni në menunë e cilësimeve të përgjithshme.

SUB	Kontrolli i përforcimit të Subwoofer
CTR	Niveli i volumnit relativ të bokseve në qendër
SIDE L	Niveli i volumnit relativ të boksit që godet nga anash
SIDE R	Niveli i volumnit relativ të boksit që godet nga djathtas
DIM	Niveli i ndriçimit të ekranit
DISP	Fikja automatike e ekranit
BT PAIR	Filloni çiftimin e Bluetooth (vetëm burimi BT)
UPGRADE	Përditësimi firmuerit me anë të USB

5 (Ekualizuesi)

Zgjidhni modalitetet e tingullit rrethues (Movie/Music/Voice/Sport/Custom).

MOVIE	EQ paraprake për filma
MUSIC	EQ paraprake për muzikë
VOICE	EQ paraprake për lajme ose emisione
SPORT	EQ paraprake për programe sportive
CUSTOM	EQ e personalizuar nga përdoruesi (kontrollohet në aplikacionin Philips Sound)

- ⑥ **Dolby Atmos**
Zgjidhni një nivel tjetër për Dolby Atmos.

- ⑦ **(Tingulli)**
Zgjidhni cilësimet e tingullit (Surround/
DRC/IMAX/Dialogue/Bass/Treble/Sync).

SUR	Opsionet e tingullit rrethues
DRC	Kontrolli i rrezes dinamike
IMAX	Opsionet e modalitetit IMAX
DLG CTRL	Rregulloni nivelin e dialogut (vetëm për DTS-X)
BASS	Rregulloni nivelin e basit për EQ paraprake
TREBLE	Rregulloni nivelin e EQ-së paraprake
SYNC	Rregulloni vonesën e sinkronizimit të audios dhe videos (vetëm HDMI)

- ⑧ ←
Dilni nga cilësimet.

- ⑨ 🔊
Heshtni ose riktheni volumn.


- Pulson në ngjyrë të kuqe kur kapaciteti i baterisë ka mbetur më pak se 20%.
- Pulson në ngjyrë të kuqe për 5 sekonda dhe më pas fiket kur kapaciteti i baterisë ka mbetur më pak se 10%.
- Ndizet në ngjyrë të kuqe kur boksi me valë është duke u karikuar (vetëm për bokset me valë të lidhur me njësinë kryesore).

- ② **Porta e karikimit USB-C**
Lidhuni me adaptorin e jashtëm USB-C të energjisë (nuk është dhënë) për përdorim pa kablo për kohë më të gjatë.

- ③ **Butoni i energjisë**
- Shtypeni për ta ndezur boksën me valë nëse ai kalon automatikisht në gjendje pritjeje.
 - Mbajeni shtypur boksën me valë për ta kaluar në gjendje pritjeje.

Subwoofer me valë

Ky produkt vjen me një subwoofer me valë.




- ① **CONNECT (Lidhje)**
Mbajeni shtypur për 5 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit mes njësisë kryesore dhe subwoofer.

- ② **Treguesi i Subwoofer**
- Kur është i ndezur, treguesi ndizet.
 - Gjatë lidhjes me valë mes Subwoofer dhe njësisë kryesore, treguesi pulson shpejt në ngjyrë të bardhë.
 - Kur lidhja bëhet me sukses, treguesi ndizet në ngjyrë të bardhë.
 - Kur lidhja dështon, treguesi pulson në ngjyrë të bardhë me ngadalë.
 - Kur lidhja me valë shkëputet për 1 minutë, treguesi fiket.

- ③ **AC MAINS~**
Lidhja me energjinë.

Bokset rrethuese të lëvizshme me valë


Ky produkt vjen me dy bokse rrethuese të lëvizshme me valë "on demand" (majtas dhe djathtas).



- ① **Drita LED e boksit**
- Pulson në ngjyrë të bardhë nëse boksi me valë nuk është i lidhur me valë me njësinë kryesore.
 - Ndizet në ngjyrë të bardhë kur boksi me valë është i lidhur me valë me njësinë kryesore, ose kur kapaciteti i baterisë është plot ose ka më shumë se 20%.

Konektorët

Kjo pjesë përmban një përmbledhje të konektorëve të disponueshëm në njësinë kryesore.



- ① **DC IN**
Lidhja me energjinë.
- ② **AUDIO IN**
Lidhuni me një dalje audio (xhek 3.5mm) në një pajisje.
- ③ **OPTICAL IN**
Lidhni një dalje audio optike me televizorin ose një pajisje dixhitale.
- ④ **USB (Për shërbim)**
Lidhni një pajisje USB për të përditësuar softuerin e këtij produkti.
- ⑤ **HDMI OUT (eARC/ARC)**
Lidhuni me hyrjen HDMI (eARC/ARC) në televizor.
- ⑥ **HDMI IN 1 / HDMI IN 2**
Lidhuni me daljen HMDI në një pajisje dixhitale.

3 Lidhja dhe konfigurimi

Kjo pjesë ju ndihmon ta lidhni këtë produkt me një televizor dhe me pajisje të tjera, dhe më pas ta konfiguroni. Për informacion rreth lidhjeve bazë të këtij produkti dhe aksesoreve, shikoni udhëzuesin e shpejtë.




Kujdes

- Për të parë shenjat identifikuese dhe vlerat e energjisë, shikoni etiketën e të dhënave mbrapa ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të jenë shkëputur nga energjia.

Vendosja

Vendoseni subwoofer të paktën 1 metër larg nga njësia kryesore, dhe 10 centimetra larg nga muri. Për efektin më të mirë të tingullit, pozicionojini të gjitha bokset drejt vendit ku uleni dhe vendosini pranë nivelit të veshit (kur jeni ulur).



Shënim


Tingulli rrethues varet nga faktorë të tillë si forma dhe madhësia e dhomës, lloji i murit dhe tavanit, dritaret dhe sipërfaqet reflektuese dhe akustika e bokseve. Eksperimentoni me pozicionet e bokseve për të gjetur konfigurimin më të mirë për ju.

Ndiqui këto udhëzime të përgjithshme për vendosjen e bokseve.

- 1 Pozicioni i uljes: Kjo është qendra e vendit të dëgjimit.
- 2 Vendoseni njësinë kryesore përballë pozicionit të uljes.
- 3 **REAR L** (mbrapa majtas) dhe **REAR R** (mbrapa djathtas): Vendosini bokset rrethuese të lëvizshme me valë në anën e majtë dhe të djathtë të pozicionit të uljes, ose në një drejtim me të ose pak mbrapa tij.
- 4 **SUBWOOFER** (subwoofer): Vendoseni subwoofer të paktën 1 metër në të majtë ose në të djathtë të televizorit. Lini rreth 10 centimetra hapësirë nga muri.

Lidhni bokset rrethuese të lëvizshme me valë

Gjithashtu mund t'i kapni bokset majtas dhe djathtas të lëvizshme me valë në njësinë kryesore për të dëgjuar audio, për shembull për të parë emisione televizive dhe lajme.



Lidhja me televizorin


Lidheni këtë produkt me televizorin. Mund të dëgjoni audio nga programet televizive nëpërmjet boksit Soundbar. Përdorni lidhjen me cilësinë më të mirë mes boksit Soundbar dhe televizorit.

Lidhuni me televizorin nëpërmjet HDMI (ARC/eARC)

Ky produkt mbështet HDMI me eARC (Enhance Audio Return Channel). eARC është një funksion i ri i standardizuar nga HDMI 2.1, i cili mbështet formatet audio përveç formateve audio që mbështeten me ARC ekzistues (Audio Return Channel). Nëse televizori juaj pranon HDMI eARC, mund të gëzoni audion e televizorit që ARC nuk mund të transferojë, si Dolby Atmos-Dolby TrueHD dhe DTS:X, ose përmbajtje LPCM multi-kanale, duke përdorur një kabllo të vetme HDMI.

Çfarë ju duhet

- Një kabllo High Speed HDMI.
- Televizori juaj pranoi si HDMI ARC, ashtu edhe HDMI-CEC (shikoni manualin e përdorimit të televizorit për hollësi).
- Për disa modele televizori, aktivizoni daljen e boksit të jashtëm nga menuja e cilësimeve të televizorit (shikoni manualin e përdorimit të televizorit për hollësi).



- 1 Duke përdorur një kabllo High Speed HDMI, lidheni konektorin **HDMI OUT** të këtij produkti me konektorin **HDMI ARC** në televizor.
 - Konektori **HDMI ARC** në televizor mund të jetë emërtuar ndryshe. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.
- 2 Në televizorin tuaj, aktivizoni veprimet HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit të televizorit.
- 3 Shtypni vazhdimisht butonin e burimit derisa **E-ARC** të shfaqet në ekran.




- Televizori duhet të mbështetë funksionin HDMI-CEC dhe ARC, dhe duhet që t'i aktivizoni ato.
- Nuk garantohet funksionimi 100% me të gjitha pajisjet HDMI-CEC.
- Vetëm kabllo e pajtueshme me HDMI 2.1 mund të pranojnë funksionin eARC.
- Nëse televizori juaj nuk pranon HDMI ARC, lidhni një kabllo audio dhe gëzoni audion e televizorit nëpërmjet këtij produkti.

Lidhja e televizorit ose pajisjeve dixhitale nëpërmjet HDMI

Nëse televizori juaj nuk mbështet HDMI ARC, lidheni Soundbar me televizorin nëpërmjet një lidhjeje HDMI standarde. Gjithashtu mund të lidhni një pajisje dixhitale, si set-top box, aparat DVD/Blu-ray ose aparat lojërash me këtë produkt nëpërmjet një lidhjeje të vetme HDMI. Kur i lidhni pajisjet në këtë mënyrë dhe luani një skedar ose një lojë,

- videoja shfaqet automatikisht në televizor,
- dhe audio luhet automatikisht në këtë produkt.

- 1 Duke përdorur një kabllo High-Speed HDMI, lidheni konektorin **HDMI OUT** në pajisjen tuaj dixhitale me **HDMI IN 1/2** në këtë produkt.
- 2 Lidheni këtë produkt me televizorin nëpërmjet **HDMI OUT**. Nëse televizori nuk përputhet me HDMI CEC, zgjidhni hyrjen e duhur të videos në televizor.
- 3 Në pajisjen e lidhur, aktivizoni veprimet HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit të pajisjes.




Lidhja e audio nga televizori ose nga pajisje të tjera

Luani audio nga televizori ose nga pajisje të tjera nëpërmjet këtij produkti. Përdorni lidhjen me cilësinë më të mirë të disponueshme në televizor, në Soundbar dhe në pajisje të tjera.

Shënim


- Kur ky produkt dhe televizori janë të lidhur nëpërmjet HDMI ARC, nuk është e nevojshme të bëhet një lidhje e audios.

Mundësia 1: Lidhni audion nëpërmjet një kablloje optike dixhitale



- Duke përdorur një kabllo optike, lidhni konektorin **OPTICAL IN** në këtë produkt me konektorin **OPTICAL OUT** në televizor ose në pajisje të tjera.
 - Konektori dixhital optik mund të jetë emërtuar OPTICAL OUT, SPDIF ose SPDIF OUT.
- Shtypni vazhdimisht butonin e burimit derisa në ekran të shfaqet **OPTICAL**.

Mundësia 2: Lidhni audion nëpërmjet një kablloje analog audioje



- Duke përdorur kabllon analoge, lidhni konektorin **AUDIO IN** në këtë produkt me konektorin **AUDIO OUT** ose me konektorët e daljes audio analoge (e kuqe dhe e bardhë) në televizor ose në pajisje të tjera.
- Shtypni vazhdimisht butonin e burimit derisa në ekran të shfaqet **AUDIO IN**.

Lidhja me energjinë

- Para se të lidhni kordonin e energjisë AC, sigurohuni që t'i keni kryer të gjitha lidhjet e tjera.
- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë të përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë njësisë kryesore.
- Lidhni kabllon e energjisë me prizën DC të njësisë kryesore, dhe më pas me një prizë energjie.
- Lidhni kabllon e energjisë me prizën AC~ të Subwoofer, dhe më pas me një prizë energjie.

Lidhja me Subwoofer

Çiftimi automatik

Subwoofer me valë çiftohet automatikisht me njësinë kryesore për lidhje me valë kur e ndizni njësinë kryesore dhe Subwoofer. Përcaktoni statusin në bazë të treguesit të Subwoofer me valë.

Sjellja e dritës LED	Statusi
Pulsim i shpejtë	Subwoofer në modalitetin e çiftimit
Ndezur konstante	Lidhja / çiftimi është bërë me sukses
Pulsim i ngadalhtë	Lidhja / çiftimi dështoi

Shënim

- Mos e shtypni butonin CONNECT (Lidhje) mbrapa Subwoofer, përveçse për çiftim manual.

Çiftimi manual

Nëse nga Subwoofer nuk dëgjohe audio, çiftojeni Subwoofer manualisht.

- 1 Shkëputeni njësinë kryesore dhe Subwoofer nga priza e energjisë, më pas lidhni përsëri pas 3 minutash.
- 2 Mbani shtypur butonin **CONNECT** (Lidhje) mbrapa Subwoofer për 5 sekonda.
- 3 Mbani shtypur **⏻** në njësinë kryesore ose në telekomandë për 5 sekonda për ta kaluar njësinë kryesore në Standby ekonomike.
- 4 Shtypni **⏻** në njësinë kryesore ose në telekomandë për ta ndezur njësinë kryesore.
 - » Treguesi në Subwoofer pulson shpejt në ngjyrë të bardhë dhe **SBW PAIRING** shfaqet në ekran.
 - » Nëse çiftimi bëhet me sukses, treguesi në Subwoofer ndizet në ngjyrë të bardhë dhe në ekran shfaqet **SBW PAIRED**.
- 5 Nëse çiftimi dështon, në ekran shfaqet **CHK SBW**. Përsëritni hapat e mësipërm.

Shënim

- Subwoofer duhet të jetë jo më shumë se 6 metra larg njësisë kryesore në një hapësirë pa pengesa (sa më afër, aq më mirë).
- Hiqni çdo pengesë mes Subwoofer dhe njësisë kryesore.
- Nëse lidhja me valë dështon përsëri, kontrolloni nëse ka konflikt ose interferencë të fortë (p.sh. interferencë nga një pajisje elektronike) anembanë vendit. Hiqini dhe provoni përsëri.
- Nëse lidhja me valë dështon ose çiftimi zgjat 1 minutë, Subwoofer kalon automatikisht në gjendje pritjeje dhe drita LED në Subwoofer fiket.

Çiftimi me bokset rrethuese të lëvizshme me valë

Bokset rrethuese të lëvizshme me valë çiftohen automatikisht me njësinë kryesore për lidhje me valë kur e ndizni njësinë kryesore dhe bokset me valë.

Çiftimi manual


Nëse nga bokset rrethuese të lëvizshme me valë nuk dëgjohe audio, çiftojini manualisht bokset me valë.

- 1 Ndizeni njësinë kryesore dhe bokset me valë.
 - » Nëse lidhja me njësinë kryesore shkëputet, drita LED në boksën me valë pulson në ngjyrë të kuqe.
- 2 Vendoseni boksën e majtë dhe boksën e djathtë me valë në njësinë kryesore për t'i çiftuar automatikisht.
 - » Nëse çiftimi bëhet me sukses, **SL PAIRED** (boksi rrethues i majtë) dhe **SR PAIRED** (boksi rrethues i djathtë) shfaqet në ekran.
- 3 Nëse çiftimi dështon, lidhni përsëri fizikisht bokset me valë në njësinë kryesore.

Karikimi i bokseve rrethuese të lëvizshme me valë

Nëse boksi rrethues i majtë/djathtë ndahet nga njësia kryesore, niveli i baterisë tregohet në dritën LED në boks.

- Ndezur në ngjyrë të bardhë: bateria është plot ose kapaciteti i mbetur është më shumë se 20%
- Pulson në ngjyrë të kuqe: niveli i baterisë është i ulët, ose kapaciteti i mbetur është më pak se 20%
- Pulson në ngjyrë të kuqe dhe fiket: pothuajse bosh, ka kapaciteti i mbetur është më pak se 10%



- 1 Vendosini bokset me valë në njësinë kryesore për t'i karikuar.
- 2 Ndizeni njësinë kryesore.
 - » Gjatë karikimit, drita LED në boksën me valë pulson në ngjyrë të kuqe.
 - » Kur është karikuar plotësisht, drita LED në boksën me valë fiket.

Shënim

- Gjithashtu mund t'i karikoni bokset me valë nëpërmjet portës së karikimit USB-C duke përdorur një kablo karikimi USB-C.
- Mund të duhen rreth 2 orë që bokset me valë të karikohen plotësisht.
- Performanca e baterisë ndryshon për shkak të shumë faktorëve, si volumni, konfigurimi i zërit dhe media që luhet.

Lidhja me Wi-Fi (punimi me valë)

(për versionin iOS dhe Android)

Duke i lidhur këtë aparat dhe pajisjet portative (si iPad, iPhone, iPod touch, telefona Android, etj.) me të njëjtin rrjet Wi-Fi, mund ta përdorni më pas aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi për të kontrolluar Soundbar për të dëgjuar skedarë audio.

- 1 Lidhni telefonin ose tabletën me të njëjtin rrjet Wi-Fi me të cilin doni të lidhni Soundbar.
- 2 Shkarkoni dhe instaloni pajisjen tuaj aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi.
 - * Sigurohuni që routeri është i ndezur dhe që funksionon si duhet.
- 3 Mbani shtypur butonin (Wi-Fi) që ndodhet në kabinetin e pasmë për 8 sekonda për të aktivizuar lidhjen Wi-Fi.
 - » Prisni derisa boksi të lëshojë një ton të dytë, dhe më pas lëshojeni butonin.
- 4 Prisni derisa treguesi LED i Wi-Fi përpara të kalojë nga një puls i shpejtë në një puls të ngadaltë. Kur fillon të pulsojë me ngadalë, kjo tregon se boksi po hyn në modalitetin e konfigurimit të Wi-Fi.

- 5 Hapni aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqni udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.
 - » Nëse lidhja bëhet me sukses, PLAY-Fi shfaqet në ekran.

Shënim

Vetëm për versionin iOS

Rrjeti Wi-Fi i përdorur përkohësisht nga iPhone duhet të kalohet përkohësisht te AP e pajisjes Play-Fi, dhe duhet ta rihapni aplikacionin Philips Sound për të përfunduar konfigurimin Wi-Fi të produktit. Shikoni hapat e mëposhtëm:

- Shkoni te Cilësimet.
- Zgjidhni konfigurimin Wi-Fi.



- Zgjidhni pajisjen Play-Fi në konfigurimin e Wi-Fi.
- Kthehuni te aplikacioni Philips Sound për të vazhduar konfigurimin.



- 6 Pas lidhjes së suksesshme të Wi-Fi, treguesi LED i Wi-Fi përpara do të ndalojë së pulsuar dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilido smartfon ose tabletë në të njëjtin rrjet.
 - » Kur e përdorni aplikacionin për të luajtur muzikë, paneli i ekranit do të shfaqë PLAY-Fi.

- 7 Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni tuajin duke zgjedhur Custom Name (Emër i personalizuar) në fund të listës së emrave. Përndryshe, do të ndiqet emri standard.
- 8 Pas lidhjes, ky produkt mund të bëjë një përditësim të sistemit.
 - » Përditësojeni në softuerin më të fundit kur bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos u largoni nga rrjeti gjatë përditësimit.

Konfigurimi i AirPlay

Përdorni AirPlay për të konfiguruar lidhjen Wi-Fi mes pajisjes iOS (iOS7 ose më i ri) dhe Soundbar.

- 1 Pajisja iOS: Settings > Wi-Fi > zgjidhni rrjetin e shtëpisë [pajisja Play-Fi (xxxxxx)].
- 2 Hapni aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi. Ndiqui udhëzimet në aplikacion për ta lidhur këtë produkt me rrjetin Wi-Fi.
 - » Pas lidhjes së suksesshme të Wi-Fi, treguesi LED i Wi-Fi përpara do të ndalojë së pulsuari dhe do të qëndrojë ndezur. Pasi ta konfiguroni këtë produkt në rrjetin tuaj Wi-Fi, mund ta kontrolloni nga cilido smartfon ose tabletë në të njëjtin rrjet.
 - » Kur e përdorni aplikacionin për të luajtur muzikë, paneli i ekranit do të shfaqë PLAY-Fi.
- 3 Pas lidhjes, mund ta ndryshoni emrin e pajisjes. Ka disa emra mes të cilëve mund të zgjidhni ose mund të krijoni tuajin duke zgjedhur Custom Name (Emër i personalizuar) në fund të listës së emrave. Përndryshe, do të ndiqet emri standard.
- 4 Pas lidhjes, ky produkt mund të bëjë një përditësim të sistemit.
 - » Përditësojeni në softuerin më të fundit kur bëni konfigurimin për herë të parë. Përditësimi i softuerit mund të zgjatë disa minuta. Mos e shkëputni boksën, mos e fikni pajisjen ose mos u largoni nga rrjeti gjatë përditësimit.



Shënim

- Pas lidhjes, produkti mund të bëjë një përditësim të softuerit. Pas konfigurimit për herë të parë, është e nevojshme të bëhet përditësimi. Pa bërë përditësimin, jo të gjitha veçoritë e produktit mund të jenë të disponueshme.
- Kur konfigurimi për herë të parë nuk bëhet me sukses, mbani shtypur butonin Wi-Fi në Soundbar për 8 sekonda derisa të dëgjohet toni dhe drita LED e Wi-Fi të kalojë në pulsime të ngadaltë. Rivendosni lidhjen Wi-Fi, rihapeni aplikacionin dhe filloni konfigurimin përsëri.
- Nëse doni të kaloni nga një rrjet te një tjetër, duhet të konfiguroni lidhjen përsëri. Mbani shtypur butonin e Wi-Fi të Soundbar për 8 sekonda për ta rivendosur lidhjen e Wi-Fi.

Modaliteti WPS

Nëse routeri juaj ka Wi-Fi Protected Setup (WPS), mund ta konfiguroni lidhjen pa formuar fjalëkalim.

- 1 Mbani shtypur butonin Wi-Fi për 4 sekonda. Do të dëgjoni një ton dhe drita LED e Wi-Fi do të pulsojë dy herë.
- 2 Shtypni butonin WPS në router. Zakonisht, butoni është shënuar me këtë logo WPS.
- 3 Ndiqui udhëzimet në aplikacionin Philips Sound të mundësuar nga DTS Play-Fi për të filluar çiftimin.



Shënim

- WPS nuk është një veçori standarde në të gjithë routerët. Nëse routeri nuk ka WPS, atëherë përdorni konfigurimin standard të Wi-Fi.
- Shtypni një herë butonin e Wi-Fi nëse doni të dilni nga modaliteti WPS, përndryshe ai do të mbyllet automatikisht pas 2 minutash.

4 Përdorimi i produktit


Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni produktin për të luajtur materiale mediatike nga të gjitha burimet.

Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme të treguara në udhëzuesin e shpejtë dhe në manualin e përdorimit.
- Kalojeni këtë produkt te burimi i duhur për pajisjet e tjera.

Vendosni bateritë para se ta përdorni telekomandën

Lëvizeni kapakun e vendit të baterive për ta hapur, vendosni 2 bateri AAA (1,5 V) me polaritetin e duhur, dhe më pas vendoseni përsëri kapakun e vendit të baterive.



Rregulloni volumnin

Shtypni +/- (Volumi) për të rritur ose ulur nivelin e volumnit.

- Për ta heshtur zërin, shtypni **⏏**.
- Për ta rikthyer zërin, shtypni përsëri **⏏** ose shtypni +/- (Volumi).

Zgjidhja e tingullit

Kjo pjesë ju ndihmon të zgjidhni tingullin ideal për videon ose muzikën tuaj.

Modalitetet EQ paraprake

Zgjidhni modalitetet paraprake të tingullit sipas videos ose muzikës suaj.

Shtypni **EQ** në telekomandë për të zgjedhur një modalitet EQ paraprak.

- **MOVIE**: Krijoni një eksperiencë dëgjimi rrethuese. Ideale për të parë filma.
- **MUSIC**: Krijoni tingull stereo me dy kanale ose shumë kanale. Ideal për të dëgjuar muzikë.
- **VOICE**: Krijoni efekt zëri që e bën zërin e njeriut më të qartë dhe më të mirë për të dëgjuar.
- **SPORT**: Krijoni një atmosferë sikur shikoni ndeshje sportive në stadium.
- **CUSTOM**: Personalizoni tingullin sipas preferencave tuaja (kontrollohet në aplikacionin Philips Sound: Settings > Fine Tune).

Rregullimi i niveleve të Bass/Treble

Ndryshoni cilësimet për frekuencën e ulët (bass) dhe frekuencën e lartë (treble) të këtij produkti.

Shtypni vazhdimisht **EQ** për të zgjedhur **BASS** ose **TREBLE**, më pas shtypni butonin e majtë dhe të djathtë të navigimit për të ndryshuar nivelin e bass ose treble.

Ndryshimet kanë efekt në modalitetet MOVIE, MUSIC, VOICE dhe SPORT EQ.

Modaliteti IMAX Enhanced

Shtypni vazhdimisht **EQ** për të zgjedhur **IMAX**, më pas shtypni butonin e navigimit majtas dhe djathtas për të aktivizuar ose çaktivizuar modalitetin IMAX.

Modaliteti	Funksioni
Auto	Modaliteti IMAX Enhanced dallohet dhe aktivizohet automatikisht.
On	Modaliteti IMAX Enhanced aktivizohet ehe për DTS 5.1 bitstreams.
Off	Çaktivizoni modalitetin IMAX Enhanced për të gjitha bitstream-et.

Modaliteti rrethues (SURR)

Shtypni vazhdimisht  për të zgjedhur **SURR**, më pas shtypni butonat e navigimit majtas dhe djathtas për të zgjedhur opsionet e modalitetit rrethues.

- **UPMX**: Modaliteti up-mixing për të nxjerrë audio në të gjithë bokset edhe kur përmbajtja e audios është me konfigurim kanalesh më pak se 5.1.2 (B95) ose 7.1.2 (B97). Teknologjia up-mixing nga Dolby ose DTS aplikohet sipas llojit të përmbajtjes.
- **STD**: Modaliteti standard për nxjerrjen e tingullit original. Dalja nga bokset do të ndjekë kanalet audio që ka përmbajtja. (Shënim: Nëse përmbajtja e audios është kanal 2.0, vetëm bokset e kanalit majtas dhe djathtas, dhe Subwoofer, do të nxjerrin zë. Përdor UPMIX nëse doni tingullin rrethues.)
- **A-I**: Funkzioni i inteligjencës mediatike të Dolby Atmos për audion në shtëpi përdoret për të përmirësuar zërin ose efektet rrethuese.

Dinamični nadzor razpona (DRC)

Mund të aplikoni Dynamic Range Control në bitstream-et Dolby ose DTS.

Shtypni vazhdimisht  për të zgjedhur **DRC**, më pas shtypni butonat e navigimit majta dhe djathtas për të aktivizuar, çaktivizuar DRC, ose për ta vendosur në gjendje automatike.

Shënim

- DRC nuk është i disponueshëm në modalitetin BT/AUDIO IN/Play-Fi.

Nadzor dialoga (DLG CTRL)

Modaliteti i dialogut përmirëson qartësinë e dialogut dhe zërave në filma, në programet televizive dhe në podkaste duke rregulluar balancën e toneve të këtij produkti.

Shtypni vazhdimisht  për të zgjedhur **DLG CTRL**, më pas shtypni butonat e navigimit majtas dhe djathtas për të ndryshuar nivelin e dialogut. Ky kontroll mbështetet vetëm në DTS:X stream.


Sinkronizimi i videos dhe zërit (SYNC)

Nëse audio dhe video nuk janë të sinkronizuar, shtypni audion që të përputhet me videon.

Shtypni vazhdimisht  për të zgjedhur **SYNC**, më pas shtypni butonat e navigimit majtas dhe djathtas për ta sinkronizuar audion me videon.

Dolby Atmos®

Përveç shpërndarjes horizontale të audios me 5 kanale, ky produkt ka edhe bokse të brendshme me Dolby Atmos si kanale shtesë të audios për të gjeneruar shpërndarje nga sipër të audios për të dhënë tingull të fuqishëm 3D për zhytje dhe realitet më të madh.



Konfigurimi optimal për tingullin Dolby Atmos

- Vendoseni këtë produkt në lartësi 0,7 m-0,8 m.
- Lartësia e tavanit është 2,8 m-3 m.
- Distanca e dëgjimit nga ky produkt është 2 m-3 m.
- Tavanin nuk është bërë me material që përthith zërin.
- Mundësisht, në tavan nuk ka objekte të dala (si ndriçime dhe zbukurime).

Dolby Atmos® është i disponueshëm vetëm në modalitetin HDMI. Për hollësi rreth lidhjes, ju lutemi shikoni "Lidhja me televizorin". Efektet më të mira të Dolby Atmos mund të arrihen në dy rastet e mëposhtme të përdorimit.

Nga aparati Blu-ray:

- Film me Dolby Atmos.
- Aparati juaj Blu-ray lidhet me këtë produkt nëpërmjet konektorit **HDMI IN 1/2**.
- Në aparatin Blu-ray, aktivizoni formatin e audios bitstream/raw për dalje HDMI të tingullit.
- Një kabllo High Speed HDMI.

Nga televizori:

- Film me Dolby Atmos.
- Televizori juaj mbështet daljen bitstream/raw Dolby Atmos.
- Televizori juaj është lidhur me këtë produkt nëpërmjet konektorit **HDMI OUT**.
- Një kabllo High Speed HDMI.



Shënim

- Eksperienca e plotë e Dolby Atmos është e disponueshme vetëm kur Soundbar lidhet me një burim nëpërmjet një kabllos HDMI 2.0.
- Soundbar do të vazhdojë të punojë kur lidhet me metoda të tjera (si për shembull me kabllo dixhitale optike), por këto nuk janë në gjendje të mbështetnin të gjitha veçoritë e Dolby. Për të siguruar mbështetje të plotë të Dolby, rekomandohet fort që ta bëni lidhjen me HDMI.

Gëzoni tingullin Dolby Atmos

Shtypni **Dolby Atmos** për të zgjedhur një nivel lartësie për efektet rrethuese sipas shijeve tuaja personale dhe sipas mjedisit.

- **ATMOS 00:** efekt minimal lartësie.
- **ATMOS 01:** efekt i vogël lartësie.
- **ATMOS 02:** efekt mesatar lartësie.
- **ATMOS 03:** efekt i madh lartësie.



Shënim

- Për lidhjet jo-HDMI (si përdorimi i Bluetooth, OPTICAL, ose AUDIO IN), gjenerohen vetëm efekte rrethuese në lartësi të kufizuar.

Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth

Duke përdorur Bluetooth, lidheni këtë produkt me pajisjen tuaj me Bluetooth (si iPhone, iPad, telefon Android, ose tabletë Android), dhe mund të dëgjoni skedarët audio që keni në pajisje nëpërmjet bokseve të këtij produkti.



Shënim

- Distanca maksimale e punimit mes këtij produkti dhe një pajisjeje me Bluetooth është rreth 10 metra.
- Transmetimi i muzikës mund të ndërpritet nga pengesat mes pajisjes dhe këtij produkti, si muri, kasa metalike e pajisjes ose nga pajisjet e tjera pranë që punojnë në të njëjtën frekuencë.
- Nëse doni ta lidhni këtë produkt me një pajisje tjetër me Bluetooth, shkëputeni lidhjen aktuale me Bluetooth më parë.

- 1 Shtypni vazhdimisht butonin e burimit për ta kaluar pajisjen kryesore te modaliteti i Bluetooth, dhe prisni derisa në ekran të shfaqet **BT PAIR** për të filluar veprimin e çiftimit.
- 2 Në pajisjen me Bluetooth, aktivizoni Bluetooth, kërkoni dhe zgjidhni "**Play-Fi Device (XXXXXX)-BT**" për të filluar lidhjen.
 - » Kur lidhja me Bluetooth të bëhet me sukses, në ekran shfaqet **BT CONNECTED**.
 - » Nëse lidhja dështon, në ekran shfaqet **BT PAIR**.
- 3 Zgjidhni dhe luani skedarë audio ose muzikë në pajisjen Bluetooth.
- 4 Për të dalë nga Bluetooth, zgjidhni një burim tjetër.

Aparati MP3

Lidheni aparatin MP3 për të luajtur skedarë audio ose muzikë.

Çfarë ju duhet

- Një aparat MP3.
- Një kabllo audio stereo 3,5 mm.

- 1 Duke përdorur kabllon audio stereo 3,5 mm, lidheni aparatin MP3 me konektorin **AUDIO IN** në këtë produkt.
- 2 Shtypni vazhdimisht butonin e burimit derisa në ekran të shfaqet **AUDIO IN**.
- 3 Shtypni butonat në aparatin MP3 për të zgjedhur dhe për të luajtur skedarë audio ose muzikë.

Play-Fi në disa dhoma

Me Play-Fi të brendshëm, Soundbar mund të sinkronizojë ose mund të grupojë disa bokse me Play-Fi për muzikë në disa dhoma, e cila ju jep mundësi ta dëgjoni të njëjtën këngë në çdo dhomë të shtëpisë ose të dëgjoni këngë të ndryshme në zona të ndryshme. Të gjitha këto kontrollohen nga aplikacioni Philips Sound. Burimi do të kalohet në Play-Fi për sa kohë Soundbar juaj është zgjedhur në aplikacion.

Për të shkarkuar aplikacionin Philips Sound, ju lutemi shikoni pjesën "Wi-Fi (Punimi me valë)". Për të mësuar më shumë rreth punimit Play-Fi, ju lutemi vizitoni play-fi.com.

Chromecast(audio) / AirPlay2 / Alexa 3PDA

Soundbar është i pajisur me shërbime që punojnë në sfond, të cilat mbështetin Chromecast(audio), AirPlay2 ose Alexa 3PDA. Kur Wi-Fi është i lidhur, mund të transmetoni audio nga pajisjet/aplikacionet përkatëse në çfarëdo kohe. Burimi do të zgjidhet automatikisht kur gjendet transmetimi përkatës.

Dëgjimi i Spotify

Përdoreni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify, ose shkoni në spotify.com/connect për të mësuar si.

5 Cilësimet

Rregullimi i nivelit të boksit

Shtypni vazhdimisht **✱** për të hyrë në menunë e cilësimeve, zgjidhni bokset poshtë dhe shtypni butonat e navigimit majtas dhe djathtas për të rregulluar nivelin e boksit

- **SUB** (Subwoofer)
- **CTR XX** (boksi i mesit)
- **SIDE L XX** (boksi majtas)
- **SIDE R XX** (boksi djathtas)

Vendos ndriçimin e ekranit

Shtypni vazhdimisht **✱** për të hyrë në menunë e cilësimeve, zgjidhni **DIM** dhe shtypni vazhdimisht butonat e navigimit majtas dhe djathtas për të rregulluar nivelin e ndriçimit të ekranit në këtë produkt.

- **HIGH** (i lartë)
- **MID** (mesatar)
- **LOW** (i ulët)

Fikja automatike e ekranit

Shtypni vazhdimisht **✱** për të hyrë në menunë e cilësimeve, zgjidhni **DISP** dhe shtypni butonat e navigimit majtas dhe djathtas për të zgjedhur **DISP ON** ose **DISP OFF**.

Gjendje pritjeje automatike

Kur luani media nga një pajisje e lidhur, ky produkt kalon automatikisht në gjendje pritjeje nëse:

- nuk shtypet asnjë burim për 15 minuta, dhe
- nëse nuk gjendet luajtje e audios/videos nga një pajisje e lidhur.

Vendosja e konfigurimeve të fabrikës

Në rast se nga ky produkt nuk ka asnjë përgjigje, mund ta rivendosni këtë produkt në parametrat standarde të programuara në fabrikë.

Në modalitetin në pritje, mbani shtypur njëkohësisht butonat **VOL +/-** në njësinë kryesore për 8 sekonda derisa në ekran të shfaqet **RESET**.

Kur rivendosja e parametrave të fabrikës të ketë përfunduar, produkti fiket dhe rindizet automatikisht.

6 Përditësimi i softuerit

Për të marrë veçoritë dhe suportin më të mirë, përditësojeni produktin me softuerin më të mirë.

Përditësimi i softuerit nëpërmjet Wi-Fi

Dy pjesë në këtë produkt mund të përditësohen nëpërmjet Wi-Fi dhe aplikacionit Philips Sound.


- 1 Sistemi Play-Fi
- 2 Sistemi i audios (Firmueri) – trajton të gjitha veçoritë e kontrollit dhe zërit

Sistemi Play-Fi

Kjo pjesë mund të përditësohet direkt nga aplikacioni Philips Sound. Pasi produkti të jetë lidhur me aplikacionin, ai do të kontrollojë menjëherë përditësimet nëse ka ndonjë version më të ri të softuerit. Ndiqni hapat në ekran për të përfunduar përditësimin. Kjo bëhet nëpërmjet valëve dhe koha që nevojitet për përditësimin është më pak se 10 minuta në kushte normale rrjeti.

Sistemi i audios (Firmueri)

Kjo pjesë mund të përditësohet nëpërmjet mjetit të veçantë (PS Fine Tune) që gjendet te menuja e aplikacionit Philips Sound (Settings > Fine Tune/ Update Firmware). Nëse ka përditësim në dispozicion, do të shfaqet ikona e shkarkimit (shiko fotografinë e dytë të aplikacionit më poshtë). Ndiqni hapat që tregohen në ekran për të kryer përditësimin.



Kujdes

- Gjatë përditësimit, smartfoni duhet të jetë i ndezur dhe të jetë në ekranin e përditësimit derisa i gjithë procesi të përfundojë.
- Mund të duhen 10-30 minuta, ndaj përgatituni që ta bëni përditësimin në kohën që produkti nuk ka nevojë të përdoret.

Përditësimi nëpërmjet USB



Kujdes

- Mos e fikni energjinë dhe mos e hiqni pajisjen USB kur është duke u kryer përditësimi i softuerit, përndryshe mund ta dëmtoni këtë produkt.
- Përditësimi mund të zgjatë rreth 8 minuta.

- 1 Shikoni në www.philips.com/support nëse keni versionin më të fundit të softuerit.
 - » Kërkoni modelin tuaj dhe klikoni "Software and drivers".
- 2 Shkarkoni softuerin në një pajisje USB.
 - » Nxirreni nga zip skedarin e shkarkuar dhe sigurohuni që dosja e nxjerrë nga zip të ketë emrin "update.zip".
 - » Vendoseni dosjen "update.zip" në direktorinë rrënjë.
- 3 Me produktin të ndezur, vendoseni pajisjen USB në portën **USB**.
- 4 Mbani shtypur njëkohësisht  dhe **VOL+** për 3 sekonda ose zgjidhni **UPGRADE** në menunë e cilësimeve.
 - » **"FW UPG"** (përditësimi i firmuerit) shfaqet në ekran.
- 5 Prisni derisa përditësimi të ketë mbaruar.
 - » Nëse përditësimi ka mbaruar, produkti fiket dhe ndizet automatikisht.

7 Montimi i produktit në mur

Para se ta montoni produktin në mur, lexoni të gjitha masat paraprake për sigurinë. (shiko "Siguria")


Montimi i njësies kryesore në mur

Shënim

- Montimi jo i mirë në mur mund të shkaktojë aksidente ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni kujdesin për klientin në vendin tuaj.
- Fiksojeni mbajtësen e murit në një mur që është në gjendje ta mbajë peshën e produktit bashkë me mbajtësen e murit.
- Para se ta montoni në mur, duhet të hiqni katër këmbët prej gome poshtë njësise kryesore, përndryshe këmbët e gomës nuk mund t'i vendosni dot përsëri.

Gjatësia/diametri i vidave


Në varësi të mënyrës së montimit të këtij produkti në mur, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.



Shikoni figurat më poshtë për mënyrën si ta montoni këtë produkt.


- 1 Shpuni 2 vrima në mur. Përdorni modelin e dhënë të letërës për t'i shënuar 2 vrimat në mur, më pas fiksoni 2 vida të përshtatshme në vrima.

- 2 Fiksojeni në mur kllapën e murit me upa dhe vida.
- 3 Kapeni këtë produkt në kllapën e murit.



Montoni bokset rrethuese të lëvizshme me valë (opsionale)

Bokset rrethuese të lëvizshme me valë mund të montohen në mur me kllapën e dhënë për montimin në mur ose mund të ngrihen duke përdorur stenda (nuk janë dhënë).



8 Të dhënat e produktit



Shënim

- Të dhënat dhe dizajni mund të ndryshohen pa u njoftuar.

Amplifikatori

- Fuqia totale output:
888 W MAX / 450 W RMS (1 %THD)
- Përgjigja e frekuencës (njësia kryesore):
150 Hz–20 kHz
- Përgjigja e frekuencës (Subwoofer):
35 Hz–150 Hz
- Raporti sinjal-zhurmë:
> 65 db(CCIR) /(sipas vlerësimit A)

Audio

- Hyrja e audios dixhitale S/PDIF:
- Optike: TOSLINK

Bluetooth

- Profili i Bluetooth: A2DP,
- Versioni i Bluetooth: 4.2
- Banda e frekuencës/Fuqia në dalje:
2402 MHz ~ 2480 MHz / ≤ 2 dBm

Wi-Fi

- Wi-Fi IEEE 802.11 a/b/g/n
- Banda e frekuencave: 2,412 – 2,472 GHz,
5,18 – 5,32 GHz, 5,50 – 5,70 GHz,
5,745 – 5,825 GHz
- Fuqia e transmetuar e frekuencës audio:
WiFi 2,4 G: 17,6 dBm; WiFi 5 G: 16,38 dBm;
WiFi 5,8 G: 8,07 dBm

Njësia kryesore

- Furnizimi me energji: Modeli (adaptor energjie i markës Philips): NSA120EC-19063200
- Hyrja: 100–240 V~, 50/60 Hz, 2,0 A
- Dalja: 19 V $\overline{\text{---}}$ 6,32 A
- Konsumi i energjisë: 25 W
- Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje: < 0,5 W

- Kanali i audios: 7.1.2
- Bokset e brendshme:
- Qendër: 2 drajvera racetrack me diapazon të plotë
- Boksi përpara: 4 drajvera me diapazon të plotë + 2 tweeter-a
- Gjuajtja sipër: 2 drajvera me diapazon të plotë
- Gjuajtja anash: 2 tweeter-a
- Mbrapa: 2 drajvera racetrack me diapazon të plotë (me valë) +2 tweeter-a
- Përmasat (Gje x La x The):
1312 x 55,6 x 120 mm
- Peshë: 5,97 kg
- Temperatura e operimit: 0°C – 45°C

Subwoofer

- Furnizimi me energji: 220–240 V~, 50/60 Hz
- Konsumi i energjisë: 20 W
- Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje: < 0,5 W
- Drajveri i boksit: 1 x Subwoofer 8"
- Impedanca: 3 ohm
- Përmasat (Gje x La x The):
230 x 400 x 407 mm
- Peshë: 9,6 kg
- Temperatura e operimit: 0°C – 45°C

Formati i audio-codec

- HDMI: Dolby Digital, Dolby Digital plus, Dolby Digital EX, Dolby TrueHD, Dolby Atmos, DTS, DTS 96/24, DTS-ES, DTS Digital Surround (5.1-ch), DTS-HD High Resolution Audio, DTS-HD Master Audio, DTS ES, DTS: X, IMAX Enhanced
- HDMI eARC: Dolby Digital, Dolby Digital plus, Dolby Digital EX, Dolby TrueHD, Dolby Atmos, DTS, DTS 96/24, DTS-ES, DTS Digital Surround (5.1-ch), DTS-HD High Resolution Audio, DTS-HD Master Audio, DTS ES, DTS: X
- Optike: Dolby Digital, Dolby Digital plus, LPCM 2ch
- Bluetooth: SBC
- Play-Fi: MPEG4 AAC, MPEG4 M4A, MP3, WAV, FLAC, AIFF

9 Zgjidhja e problemeve



Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse keni probleme me përdorimin e produktit, shikoni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse ende keni problem, kërkonti ndihmë në www.philips.com/support

Njësia kryesore

Butonat në aparatin kryesor nuk punojnë.

- Shkëputeni nga energjia për pak minuta, më pas lidhni përsëri.

Zëri

Nga boksi i Soundbar nuk ka zë.

- Lidhni kabllo e audios nga Soundbar në televizor ose në pajisje të tjera. Megjithatë, nuk ju duhet një lidhje e veçantë audio kur:
 - Soundbar dhe televizori janë lidhur me anë të lidhjes HDMI ARC, ose
 - në konektorin HDMI IN në Soundbar është lidhur një pajisje.
- Zgjidhni hyrjen e duhur të audios në telekomandë.
- Sigurohuni që Soundbar nuk është heshtur.
- Rivendoseni këtë produkt në parametrat e fabrikës (shiko "Apliko parametrat e fabrikës").

Nuk ka zë nga Subwoofer me valë.

- Lidhni manualisht Subwoofer me njësine kryesore (shiko "Lidhja me Subwoofer").

Tingulli është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet këtij produkti, sigurohuni që televizori të heshtet.

Audio dhe televizori nuk janë të sinkronizuar.

- Shtypni  për të sinkronizuar audion me videon.

Bluetooth

Pajisja nuk mund të lidhet me Soundbar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për Soundbar.
- Nuk keni aktivizuar funksionin Bluetooth në pajisje. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të parë se si ta aktivizoni funksionin.
- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidhni pajisjen si duhet.
- Soundbar është lidhur tashmë me një pajisje tjetër Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, pastaj provoni përsëri.

Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje Bluetooth është e dobët.

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni pajisjen me Soundbar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe Soundbar.

Wi-Fi

Nuk është e mundur të bëhet lidhja e Wi-Fi.

- Shikoni disponueshmërinë e rrjetit WLAN në router.
- Afrojeni më shumë routerin Wi-Fi me këtë produkt.
- Sigurohuni që fjalëkalimi është i saktë.
- Kontrolloni funksionin WLAN ose rindizeni modemën dhe routerin Wi-Fi.

Dolby Atmos

Nuk është e mundur të arrihen efektet e Dolby Atmos.

- Për lidhjet jo-HDMI (si përdorimi i Bluetooth, OPTICAL, ose AUDIO IN), efektet rrethuese gjenerohen në lartësi të kufizuar. Shikoni pjesën e "Dolby Atmos" për të parë se si të arrini efektet më të mira të Dolby Atmos.

Play-Fi

Nuk është e mundur të gjenden pajisjet që mbështetin Play-Fi në aplikacion.

- Sigurohuni që pajisja është lidhur me Wi-Fi.

Nuk është e mundur të luhet muzikë Play-Fi.

- Disa shërbime ose përbajtje rrjeti që disponohen përmes pajisjes, mund të mos jenë të përdorshme në rast se ofruesi i shërbimit e mbyll shërbimin e tij.

COMPATIBLE WITH



Dolby, Dolby Vision, Dolby Atmos dhe simboli me dy D janë marka të regjistruara tregtare të Dolby Laboratories Licensing Corporation. Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Punime konfidenciale të papublikuara. Copyright © 2012–2020 Dolby Laboratories. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



Prodhuar me licencë nga IMAX Corporation. IMAX® është një markë tregtare e regjistruar e IMAX Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera. Prodhuar me licencë nga DTS Licensing Limited. DTS, simboli, dhe DTS bashkë me simbolin, janë marka tregtare të regjistruara ose marka tregtare të DTS, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



Prodhuar me licencë nga DTS Licensing Limited. DTS, simboli, dhe DTS bashkë me simbolin, DTS:X, dhe logoja DTS:X janë marka të regjistruara tregtare ose marka tregtare të DTS, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe/ose në shtete të tjera. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



Për patentat e DTS, shikoni <http://patents.dts.com>. Prodhuar me licencë nga DTS, Inc. (për kompanitë me seli në SHBA/Japoni/Tajvan) ose me licencë nga DTS Licensing Limited (për të gjitha kompanitë e tjera). DTS, Play-Fi dhe logoja DTS Play-Fi janë marka të regjistruara tregtare ose marka tregtare të DTS, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera. © 2020 DTS, Inc. TË GJITHA TË DREJTAT E TJERA TË REZERVUARA.



Për ta kontrolluar këtë boks me AirPlay 2, nevojitet iOS 11.4 ose më i ri. Përdorimi i veprave me distinktivin Apple do të thotë që një aksesori është ndërtuar të punojë specifikisht me teknologjinë që tregohet në

distinktiv dhe që është certifikuar nga prodhuesi se përputhet me standardet e Apple për performancën. Apple® dhe AirPlay® janë marka tregtare të Apple Inc., të regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.



Markat tregtare të adoptuara HDMI, HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të HDMI Licensing Administrator, Inc. në Shtetet e Bashkuara dhe në shtete të tjera.



Logoja Wi-Fi CERTIFIED™ është një markë e regjistruar tregtare e Wi-Fi Alliance®.



Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat tregtarë të tjerë janë të pronarëve të tyre përkatës.



Chromecast është markë tregtare e Google Inc. Google Play dhe logoja e Google Play janë marka tregtare të Google Inc.



Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

2020 © Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose të ndonjë prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

